

BASHKIA POLIÇAN
NJOFTIM ANKANDI

1. Autoriteti dhënies në përdorim: Bashkia Poliçan, (adresa, nr. tel) Lagjia “Qender” Poliçan
Tel: 036824200 , e-mail: njvbashkiapolican@gmail.com , info@bashkiapolican.gov.al
2. Data e zhvillimit të ankandit 20.01.2024, ora 10:00.
3. Lloji i Procedurës standarde të ankandit : Procedurë e Hapur
4. Objekti : Dhënie në përdorim të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor “Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë”.
5. Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes:
Dhënie në përdorim të sipërfaqes pyjore / kullosore nga 24 Ekonomia Pyjore Mali Tërpan , pasurite me nr 974/7 zk 3584 e llojit kullote sip. 174000 m² , në pronësi të bashkisë Poliçan për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë .
6. Vlera fillestare: 3 074 400 (tre milion e shtatëdhjetë e katër mijë e katërqind) Lekë/Vit .
(Referuar V.K.M-së Nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhenien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si edhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore” shtojca 1 /pika 8).

7. Afati i dhënies në përdorim: është 10(dhjete) vjet, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.
8. Vleresimi i ofertave konkurruese do të bëhet me pikë si vijon:
 - projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10 000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit - 20 pikë;
 - planbiznesi dhe investimet që do të bëhen -15 pikë;
 - planin e rehabilitimit të sipërfaqes -25 pikë;
 - nivelin e punësimit në veprimtari -5 pikë;
 - masën e qirasë për ha/vit -35 pikë
10. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim janë:
 - a) formularin e sigurimit të ofertës për shumën dhe vlefshmërinë kërkuar, në dokumentet standarde të konkurimit.
 - b) ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë.
 - c) certifikatën e regjistrimit në organin tatimor ose NIPT-in.
 - d) në rastin e personave fizik dokumenti origjinal i identifikimit një kopje e të cilit depozitohet pranë komisionit të vlerësimit të ofertave.
 - e) vërtetim nga prokuroria, gjykata që subjekti nuk ka procese gjyqesore në ngarkim, hetim në proces, Vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore se nuk ka detyrime tatimore, si dhe vërtetim për shlyerjen e Taksave Vendore.
 - f) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimit të parashikuar në plan-biznes.
 - g) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV në profesionale të tregohet prova në fushën e veprimtarisë.
11. Dokumentacioni i nevojshëm:
 - a. Kërkesën e subjektit për marrjen me qira të pasurisë shtetërore, së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
 - b. Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
 - c. Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
 - d. Të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
 - e. Planin e rehabilitimit të sipërfaqes;
 - f. Nivelin e punësimit në veprimtari;
 - g. Çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
 - h. Adresën e subjektit, telefon, e-mail dhe faks;
 - i. Leje mjedisore për aktivitetin e kërkuar
 - j. Ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë.

12 Vendi i zhvillimit të ankandit/Adresa: Bashkia Poliçan

13. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: 20.01.2024 ora 10:00..

14. Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund te terhiqen prane autoritetit shites

Dokumente me pagesë:

	Po	X	Jo	<input type="checkbox"/>
<i>Nëse Po</i>				
	Monedha	lek	Çmimi	1000

15. Dokumentet standarde te ankandit përbehen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për oferte;
- Formulari i njoftimit te fituesit;
- Formulari i publikimit te njoftimit te fituesit;
- Procesverbali/et i/e Komisionit te Vlerësimit te Ofertave.

16. Dokumentacioni duhet të paraqitet në zarf të mbyllur, të nënshkruar nga konkurruesi me mbishkrimin “Ofertë për dhënie përdorim”, dhe i dorëzohen komisionit të posaçëm për vlerësimin e dokumentacionit, në orën e hapjes së procedurës së konkurrimit. Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme ose paraqitja e dokumentave të rremë, përbën kusht skualifikues. Ofertat dorëzohen nga konkurrenti/ët e interesuar, fizikisht me postë ose dorazi në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurrimit.